



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.4, datë 07.12.2022

PËR
RINOVIMIN E LEJES ME NR.917/1 PROT., DATË 29.9.2017
DHËNË ME VENDIM NR.12 DATË 13.9.2017 NGA KBU SEMAN
“PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR PËR
QËLLIME INDUSTRIALE (LAVAZHO)”,
SUBJEKTIT “DIANA SULAJ”

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit uJOR, e lejes/autorizimit për përdorim burimi uJOR, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit uJOR, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit UJOR Seman.

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes me nr.917/1 prot., datë 29.9.2017 dhënë me vendim nr.12 datë 13.9.2017 nga KBU Seman për “Përdorim burimi uJOR nËntokËsor për qËllime industriale (lavazho) subjektit “Diana Sulaj” me Adresë Lagjja “11 janari” Rruga “Ramis Aranitasi” Pallati 58 Fier Qarku Fier.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë
Vendndodhja e veprës së marrjes (KRGJSH)
- X= 463140.1; Y= 4510626.5; Z= 16.6 m.m.n.d
Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.2 l/s

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

